



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/286

Datë: 28.01.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 08/L - 036 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 janar 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes për dërgimin e Kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar në Republikën e Shqipërisë.
2. Mjetet financiare për dërgimin e Kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar, sipas pikës 1. të këtij Vendimi sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia procedojë Presidentes së Republikës së Kosovës me qëllim të dhënies së autorizimit sipas legjislacionit në fuqi për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, si dhe të njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës me përmbajtjen e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë